



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR
ZYRA E REKTORIT

Nr. 1481 Prot

Datë 03 / 12 2021

URDHËR

Nr. 85, datë 03.12 2021

PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE PËRFAQËSUES TË UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ" NË BORDIN E ADMINISTRIMIT

Bazuar në Ligjin Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 48, pika 1, 2, 6; Statutin e Universitetit "Eqrem Çabej", neni 20, pikat 2, 3, 5,

URDHËROJ

Zgjedhjen e anëtarëve përfaqësues të Universitetit "Eqrem Çabej" në Bordin e Administrimit si më poshtë vijon:

1. Periudha e regjistrimit të kandidatëve për anëtarët e Bordit të Administrimit, përfaqësues të Universitetit "Eqrem Çabej" fillon në orën 08.00 të datës 6 (gjashtë) dhjetor 2021 dhe përfundon në orën 16.00 të datës 10 (dhjetë) dhjetor 2021;
2. Kanë të drejtë të kandidojnë anëtarë të personelit akademik të punësuar me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar dhe angazhim me kohë të plotë, që kanë të paktën 10 (dhjetë) vite punë në UGJ;
3. Nuk kanë të drejtë të kandidojnë për anëtarë të Bordit të Administrimit autoritetet e zgjedhura (rektori, administratori, drejtuesit e njësive kryesore, drejtuesit e njësive bazë) dhe përfaqësuesit në organet e zgjedhura të UGJ-së;
4. Dokumentacioni i nevojshëm për kandidim:
 - a. Kërkesa nga personeli që vetëkandidon, e cila depozitohet pranë zyrës së asistentes së rektorit brenda afateve të përcaktuara në pikën 1 (një) të këtij urdhëri;

- b. Propozimet e njësive bazë (për kandidatët që propozohen prej tyre), të firmosur nga mbi 50% e antarësisë së njësisë, të cilat përcillen zyrtarisht nga drejtuesit e njësive bazë pranë zyrës së asistentes së rektorit, brenda afateve të përcaktuara në pikën 1 (një) të këtij urdhëri;
- c. Çdo njësi bazë mund të propozojë vetëm një kandidat;
- d. Vërtetim për secilin kandidat të lëshuar nga Drejtoria e Shërbimeve Ndhmës-Akademike Administrative për:
- kohëzgjatjen e marrëdhënieve të punës me kontratë me afat të pacaktuar dhe angazhim me kohë të plotë;
 - mospasje të masave disiplinore;
 - mospërbushjen e moshës së pensionit sipas ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";
- e. Plotësimin e deklaratës që kandidati nuk është:
- në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar;
 - i dënuar ose ndaj tij nuk është dhënë masë sigurie apo dënim me vendim jo përfundimtar për kryerjen e krimeve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", të ndryshuar;
 - objekt i ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";
5. Lista e kandidatëve të vetëkandiduar apo propozuar për anëtarë të Bordit të Administrimit i përcillet Senatit Akademik brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga përfundimi i afatit të caktuar në pikën 1 (një) të këtij urdhëri;
6. Senati Akademik me votim të fshehtë zgjedh 3 (tre) anëtarët e Universitetit "Eqrem Çabej" në Bordin e Administrimit;
7. Anëtarët e Senatit Akademik kanë të drejtë të votojnë jo më shumë se tre kandidatë;
8. Shpallen anëtarë të Bordit të Administrimit tre kandidatët me më shumë vota.

Prof.dr.Bektash MEMA

REKTOR